
11

Kisha e Testamentit të Ri

Fotografitë pëlqehen nga shumë prej nesh për arsye të vlerës praktike dhe sentimentale që ato kanë. Një gjë është e sigurt, ato rifreskojnë *kujtesën tonë*. Përmes mirësisë së Perëndisë, unë dhe familja ime morëm pjesë në një seminar për predikuesit, të mbajtur në Samoan Amerikane, verën e vitit 1992. Samoanët janë njerëz bujarë e të dashur dhe nuk duhet shumë kohë për një vizitor të fillojë të ushqejë një ndjenjë dashurie dhe vlerësimi të thellë për ta. Ne të gjithë, që në momentin që zbritën nga aeroplani, u pritëm me gjithë zemër nga Samoanët. Nga ana tjetër, ata hynë menjëherë në zemrat tona. Regjistruam me kamera pjesë të shumta nga seminari, nga kisha dhe nga aktivitetet tona së bashku. Me të vërtetë, këto regjistrime janë një thesar për ne. Ndonjëherë i shikojmë dhe kujtojmë vëllezërit tanë, që jetojnë larg në Samoan Amerikane. Për skena të veçanta themi: «Po, më kujtohet ky moment.» Këto regjistrime na kujtojnë fytyrat e njerëzve dhe gjithë kohën e mrekullueshme që kaluam me ta, gjatë seminarit. Në një mënyrë të habitshme, regjistrimet i ngacmojnë kujtimet tona.

Gjithashtu, fotografitë na ndihmojnë, sepse ato qartësojnë gjëra që mund të kenë qenë të paqarta më parë. Kur

mendojmë për diçka që nuk e kemi dëgjuar më parë, një fotografi mund të heqë konfuzionin dhe të na ndihmojë që të arrijmë në kuptimin e vërtetë. Për shembull, mund të diskutojmë për një kohë të gjatë karakteristikat e shtëpisë kristiane, por pa fituar ndonjë gjë të madhe. Në qoftë se ne vizitojmë dhe shikojmë një shtëpi të vërtetë kristiane, pasi kemi dëgjuar shpjegime për të, një shtëpi që është një shembull i gjithë cilësive të një shtëpie që në krye të saj ka Krishtin, atëherë ideja e shtëpisë kristiane bëhet e kuptueshme dhe e fuqishme! Koncepti bëhet i qartë nga pamja që shikuam. Pamjet apo modelet na ndihmojnë të krijojmë në mendjet tona realitetin e dhënë me anë të mendimit abstrakt.

Perëndia, për të na shpjeguar të vërtetat e gjendura në Bibël, ka përdorur mendimin dhe përshkrimin. Pas pothuajse çdo prezantimi të një të vërtete, Ai do të përdorë ilustrime apo shembuj të qartë për ta bërë më të kuptueshme këtë ide apo të vërtetë. Ai dha modele që shoqërojnë urdhërat e Tij për të na ndihmuar t'i kuptojmë ato dhe shembuj për të qartësuar shpjegimet e Tij.

Ne e shikojmë këtë cilësi të veçantë të zbulimit të Tij në paraqitjen e kishës së ndërtuar prej Jezusit. Ai shpjegoi në mënyra të ndryshme karakteristikat dhe imazhin e kishës së Krishtit dhe pastaj dha modele apo pamje të jetës reale të kishës.

Përshkrimi i parë që Testamenti i Ri jep për kishën, gjendet në pjesën e fundit të kapitullit të dytë të Veprave. Ungjijtë na kanë krijuar një ndjenjë pritjeje dhe shprese për pamjen e kishës. Në ta gjejmë profecitë rreth kishës, të dhëna nga Jezusi dhe apostujt e Tij (Mateu 16:18; Marku 9:1; Veprat 1:4–8). Pastaj, në Veprat 2, ku përshkruhet themelimi i kishës, gjendet edhe një përshkrim plot jetë i kishës, i dhënë nga Fryma e Shenjtë.

Kjo pamje e kishës na ndihmon të shikojmë karakteristikat kryesore të saj. Ne tashmë e dimë se si kisha që Jezusi themeloi, duket në të vërtetë.

Shikoni me kujdes karakteristikat kryesore të kishës, në përshkrimin e dhënë nga Lluka te Veprat 2:

Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimit të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje.

Dhe të gjithëve u kishte hyrë druajtja; dhe shumë shenja e mrekulli bëheshin nga dora e apostujve. Por gjithë ata që besonin rrinin bashkë dhe çdo gjë e kishin të përbashkët. Dhe i shisnin pronat e pasuritë dhe ua ndanin të gjithëve, sipas nevojës së çdonjërit. Dhe ngulmonin me një mendje të vetme çdo ditë në tempull dhe, duke e thyer bukën nga shtëpia në shtëpi, merrnin ushqimin me gëzim dhe me thjeshtësi zemre, duke lavdëruar Perëndinë dhe duke gëzuar simpatinë e gjithë popullit. Dhe Zoti i shtonte kishës çdo ditë ata që ishin shpëtuar (Veprat 2:42–47).

Çfarë karakteristikash të kishës shikojmë në këtë përshkrim?

DEVOTSHMËRIA

Karakteristika e parë është devocioni i patundur në doktrinën apo mësimin e apostujve. Ata me besim po ndiqnin atë që Perëndia u kishte dhënë përmes apostujve të frymëzuar. Lluka tha: «Ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimit të apostujve, në bashkësi, në thyerjen e bukës dhe në lutje» (Veprat 2:42).

Dedikimi i kishës ndaj mësimit të apostujve u manifestua në ndjekjen besnike të mësimit të tyre, në takimin së bashku për të adhuruar, për të shërbyer dhe për të kontribuar, në marrjen e Darkës së Zotit apo në thyerjen e bukës¹ dhe në lutje. Krishti ishte kreu i tyre dhe ata e pranonin udhëheqjen e Tij në kishën e Tij duke nderuar Fjalën e Tij, të dhënë nga apostujt.

Nuk duhet të pajtohem me ekzistencën e ndarjeve të besimit kristian, sepse ajo çorodit thjeshtësinë e faktit që ne, si kisha e Tij, kemi vetëm Jezusin si udhëheqës. Kisha nuk u krijua nga njerëzit. Kisha është një grup njerëzish që ndjekin mesazhin e Frymës së Shenjtë dhe kështu, me anë

të bindjes së tyre ndaj ungjillit, qëndrojnë të bashkuar në kishën e Krishtit, të ndihmuar nga Fryma e Shenjtë. Ata i përkasin vetëm Krishtit. Ata nuk kanë udhëheqje njerëzore, por janë të udhëhequr nga kreu i trupit, Krishti, përmes Fjalës së Tij, që na është bërë e njohur. Besnikëria ndaj Krishtit do të thotë që ata të jetojnë sipas Fjalës së Tij të frymëzuar.

David Lipscomb, themeluesi i kolegjit kristian që mban emrin e tij, singërisht besonte në jetesën si anëtar i kishës së Krishtit. Ai kurrë nuk ishte bërë anëtar i ndonjë ndarjeje fetare. Ai mbante vetëm emrin «kristian» dhe kërkonte të ndiqte Shkrimet në çdo detaj. Devocioni i tij për Krishtin ishte i dukshëm në përpjekjet e përditshme për të studiuar Shkrimet dhe në predikimin e mësimdhënien e Shkrimeve. Jetesa me Shkrimet u bë kaq shumë pjesë e tij, sa, kur pleqëria i mori shikimin, ai akoma do të ulej në verandën e tij, në freskinë e mbrëmjes, me Biblën në prehër. Edhe pse Bibla mund të ishte me kokë poshtë, ai e mbante atë me shumë kujdes. Një jetë e tërë në kryerjen e vullnetit të Krishtit, ashtu siç tregohet në Shkrimet, reflektohej në paqen në të cilën prehej shpirti i tij.

Kisha e Krishtit ekziston vetëm atje ku njerëzit i binden ungjillit të Krishtit dhe jetojnë përditë me Fjalën e Tij të frymëzuar. Kristianët duhet ta zbatojnë këtë fjalë përditë dhe me besnikëri. Bibla i udhëheq kristianët në nderimin që ata i bëjnë Perëndisë, në punën e tyre si të ishte dora e Krishtit duke punuar në këtë botë dhe në jetën e tyre të përditshme kushtuar Krishtit.

Kur shikojmë përshkrimin e dhënë nga Fryma e Shenjtë për kishën, ne shikojmë dedikimin e thellë ndaj Krishtit si një nga karakteristikat kryesore të saj.

ZEMËRGJERË DHE TË DHEMBSHUR NË SHËRBIMIN NDAJ NJËRI-TJETRIT

Një karakteristikë tjetër që ne e shikojmë në këtë

përshkrim hyjnor të kishës se anëtarët e kishës i shërbejnë njëri-tjetrit me zemërgjerësi dhe dhembshuri. Bindja e tyre e sinqertë ndaj të vërtetës prodhoi një dashuri mirësie për njëri-tjetrin. Lluka tha: «Dhe i shisnin pronat e pasuritë dhe ua ndanin të gjithëve, sipas nevojës së çdo njërit» (Veprat 2:45).

Hebrenjtë kishin ardhur nga gjithë Perandoria Romake për të festuar Ditën e Rrëshajëve. Ata menduan se ky festim do të ishte si çdo festim tjetër, por, për çudinë e tyre, nuk ishte. Kjo ishte dita historike të cilën profetët e kishin paralajmëruar. Pasi dëgjuan mesazhin e Pjetrit, shumë nga hebrenjtë vendosën të bëheshin kristianë (Veprat 2:41). Bindja e tyre ndaj Krishtit do të thoshte një ndryshim rrënjësor për ta. Por, ata duhet të qëndronin në Jeruzalem dhe të udhëzoheshin më tej nga apostujt për kishën, pjesë e së cilës ata ishin tani. Vendimi i menjëhershëm për të qëndruar në Jeruzalem do të ishte i vështirë për disa prej tyre, sepse ata nuk kishin bërë plane për një qëndrim të tillë. Pa dyshim, ata do të kishin nevojë për ushqim dhe vend për të qëndruar. Si iu përgjigjën kristianët e tjerë (vendasit), që nuk ndodheshin në një situatë të vështirë si kjo, vëllezërve dhe motrave të tyre nga vendet e largëta që ishin në vështirësi? Përgjigjja e tyre është një demonstrim dashurie dhe dhembshurie të pashoqe. Disa shitën shtëpitë dhe tokën me qëllim që të kujdeseshin për këta vëllezër. Veprimet e tyre janë një shembull i qartë i asaj dhembshurie që duhet të karakterizojë vazhdimisht kishën e Krishtit.

E vërteta që e bën ndihmën e tyre të mrekullueshme përtej imagjinatës, është se dhuratat ishin tërësisht vullnetare. Dhënia e tyre nuk ishte kërkuar apo shtyrë nga apostujt (Veprat 5:4). Por dhënia e tyre buroi nga zemrat me dhembshuri të thellë dhe me dashuri si ajo e Krishtit. Krishti u kishte dhënë atyre një natyrë të re, një natyrë që ishte larg të jetuarit vetëm për vete.

Çfarë po ndodhte nuk ishte thjesht një dhënie apo

ndarje e gjërave, kështu që të gjithë të mund të ishin të barabartë apo të zotëronin të njëjtën sasi të mirash materiale. Ajo nuk ishte një jetesë e përbashkët, ajo ishte një dashuri mirësie. Ata u dhanë njerëzve që kishin nevojë. Ata plotësuan *nevojat* dhe jo *lakmitë*. Ata e dinin se *çdo rast i jashtëzakonshëm si ky kërkonte të vepronte me shpejtësi*. Kur njerëzit kishin nevoja, të tjerët vepronin të shtyrë nga dashuria për t'i plotësuar këto nevoja, edhe pse kjo mund të kërkonte sakrifica!

Lluka shkruan më vonë për kishën: «Sepse midis tyre nuk kishte asnjë nevojtar, sepse të gjithë ata që zotëronin ara ose shtëpi, i shisnin dhe sillnin fitimet nga gjërat e shitura dhe i vinin te këmbët e apostujve; pastaj secilit i jepej, sipas nevojës së tij» (Veprat 4:34–35). Ai gjithashtu shkruan: «Askush nuk thoshte se ç'kishte ishte e veta, por të gjitha gjërat i kishin të përbashkëta» (Veprat 4:32).

Shpesh u them studentëve të mi në Universitetin Harding, kur ata përgatiten për të udhëtuar në shtëpi gjatë pushimeve: «Në qoftë se keni probleme me makinën tuaj apo ndonjë lloj tjetër shqetësimi gjatë udhëtimit, thjesht kujtohuni t'u telefononi vëllezërve tuaj kristianë në qytetin ku keni ngecur. Ata do t'ju ndihmojnë.» Dashuria dhe kujdesi për secilin anëtar të familjes në kishën e Krishtit, kapërcen zotërimet materiale dhe ambicjet egoiste.

Në Samoan Amerikane, unë mësova se njerëzit në çdo fis kujdeseshin për nevojat e çdo anëtari të fisit, përpara se të mendonin për ndonjë dhuratë. Plotësimi i nevojës vinte i pari, pavarësisht nga gjithë ëndërrat apo dëshirat, nevojat plotësoheshin të parat. Në të njëjtën mënyrë, kisha e Krishtit duhet të dallohet për kujdesin dhe dashurinë që ka për çdo anëtar të saj.

Dhembshuria është cilësia kryesore e kishës së Krishtit. Kisha e Tij nuk mund të ekzistojë, në qoftë se nuk demonstron bindje besnike ndaj Fjalës së Tij dhe kisha e Tij as që mund të ekzistojë përderisa dhembshuria nuk demonstron si një

shprehje e vetë zemrës së Krishtit. Kristianët e vërtetë e duan njëri-tjetrin me një dashuri vëllazërore aktive, e cila buron nga dashuria e Perëndisë që mbush zemrat e tyre. Gjoni shkroi: «Dhe, nëse njëri ka të mirat e kësaj bote dhe sheh të vëllanë që është në nevojë dhe e mbyll zemrën e tij, si qëndron në të dashuria e Perëndisë?» (1 Gjon 3:17).

Në përshkrimin e parë të dhënë nga Fryma për kishën, shërbesa e singertë ndaj njëri-tjetrit është vërtet një karakteristikë e rëndësishme.

TË BASHKUAR NË KRISHT

Karakteristika e tretë e kishës së Krishtit e parë në këtë përshkrim është uniteti i saj. Fryma e Shenjtë, me anë të bindjes së këtyre njerëzve ndaj ungjillit dhe mësimeve të apostujve, u ka dhënë anëtarëve të kishës së Krishtit unitet mendimi. Lluka tha: «Por gjithë ata që besonin, rrinin bashkë dhe çdo gjë e kishin të përbashkët» (Veprat 2:44). Më tej tha: «Dhe ngulmonin me një mendje të vetme çdo ditë në tempull dhe, duke e thyer bukën nga shtëpia në shtëpi, merrnin ushqimin me gëzim dhe me thjeshtësi zemre» (Veprat 2:46).

Ndërsa e ruajmë këtë unitet të mrekullueshëm që ekziston në kishën që ndërtoi Jezusi, le të kujtojmë rëndësinë e përshkrimit të parë të kishës. Ky përshkrim na jep një pamje të kishës së themeluar nga Krishti, e cila ishte një nga qëllimet e ardhjes së Jezusit në tokë. Por çfarë është në vetvete kisha që Jezusi themeloi? A është një organizatë e madhe me shumë institucione të ndryshme që mbajnë emra të ndryshëm, që veprojnë me sisteme besimesh të ndryshme dhe nuk kanë marrëdhënie me njëra-tjetrën? Apo Jezusi krijoi një trup të bashkuar mbi të cilin Ai mbretëron si kreu? Në këtë Ditë të Rrëshajëve, ne shikojmë imazhin më të qartë në ndoshta gjithë Testamentin e Ri të kishës, ashtu si Jezusi e do atë dhe ashtu si ajo duhet të jetojë në botë. Ky përshkrim në mënyrë të pagabueshme tregon se uniteti i

mendimit dhe i veprimit ishte karakteristikë e kishës së hershme. Kjo duhet të jetë ajo që Krishti dëshiron për kishën e Tij sot. Ndarja që dominon botën fetare, është një shenjë e sigurt se njeriu, me kriteret e tij tokësore, e ka lënë kishën e Krishtit dhe ka krijuar kisha sipas dëshirës.

Uniteti i kishës së Perëndisë mund të ilustruhet me martesën. Burri dhe gruaja, të ndryshëm nga përvojat e jetës dhe nga origjinat familjare, bëhen një gjatë martesës (Efesianëve 5:31). Pas ceremonisë të martesës, ata janë të bashkuar në një familje të re. Ata i përkasin njëri-tjetrit dhe ata marrin një natyrë të re. Ambicjet egoiste dhe qëllimet personale vdesin, ambicje dhe qëllime të reja në funksion të kësaj familjeje të re zëvendësojnë ato të vjetrat. Ata punojnë së bashku në unitet, duke qenë një në zemër dhe shpirt, duke punuar së bashku për mbarëvajtjen dhe të ardhmen e shtëpisë (familjes) së tyre. Si iu dha ky unitet atyre? Iu dha nëpërmjet dëshirës së tyre për të hyrë në martesë dhe nëpërmjet konsensusit për të zbatuar ligjin e martesës. Si e ruajnë ata këtë unitet? Ata e ruajnë duke dashur njëri-tjetrin, duke u kujdesur për njëri-tjetrin, duke falur njëri-tjetrin, duke nderuar dhe respektuar besëlidhjen e tyre martesore dhe duke nderuar faktin që familja është një nga bekimet më të mëdha të jetës.

A nuk është kjo e vërtetë për kishën? Si hyjmë ne në unitetin e kishës? Me anë të dëshirës personale, vendosim t'i japim veten tonë ungjillit të Krishtit dhe të hyjmë në trupin e Tij, kishën. Kur hyjmë në atë trup, ne bashkohemi përmes Frymës së Shenjtë me Krishtin dhe me çdo anëtar të tij. Të bashkuar në zemër dhe shpirt, fillojmë të duam, të shërbejmë dhe të jetojmë si trupi i Tij. Si e ruajmë këtë unitet? Ne e mbajmë këtë unitet të paprishur duke dashur dhe falur njëri-tjetrin dhe duke nderuar Fjalën e shenjtë të Krishtit në shërbesë, nderim dhe në jetën e përditshme.

Një karakteristikë e pamohueshme e kishës së Krishtit është uniteti. Kisha e vërtetë e Krishtit nuk mund të ekzistojë

kur ndarja dominon. Ky unitet na jepet nga Fryma e Shenjtë, kur hyjmë në trupin e Krishtit (në kishë) dhe, ndërsa jetojmë si trupi i Tij, ose do të kontribuojmë në dobësimin e këtij trupi, ose në fuqizimin e tij. Ndarja në trupin e Krishtit duhet të jetë e papranueshme për çdo kristian. Sipas pamjes së dhënë nga Fryma e Shenjtë, vendi ku uniteti gjendet në këtë botë, është trupi i Krishtit.

KONKLUZIONI

Përshkrimi i dhënë nga Fryma e Shenjtë për kishën në Testamentin e Ri tregon tri cilësi të dukshme, të cilat e dallojnë kishën e Krishtit nga gjithë institucionet e tjera fetare në të gjithë historinë. E para, kisha e Tij është një grup njerëzish që i binden Krishtit dhe me besnikëri jetojnë sipas Fjalës së Tij të frymëzuar. E dyta, kisha e Tij karakterizohet nga dhembshuria për çdo anëtar dhe kjo vjen nga dashuria që i konsideron shumë më të rëndësishme nevojat se sa zotërimet e çdo anëtari të kishës. E treta, çdo njeri që hyn në kishën e Krishtit përmes ungjillit është bërë një me Krishtin dhe me gjithë anëtarët e tjerë, me ndihmën e Frymës së Shenjtë dhe mban unitetin me anë të dashurisë së Tij dhe të jetuarit e përditshëm me Fjalën e Krishtit. Kisha është si një familje që ka një zemër dhe një jetë të përbashkët!

Atëhere, si mund të bëhemi kisha e Krishtit sot? Dy fjalë e përshkruajnë metodën: «imitimi» (të ndjekurit e modelit) dhe «dedikimi». Le të bëhemi ndjekës të Krishtit siç është treguar në këtë mësim. Këta njerëz dëgjuan Fjalën e Krishtit ashtu siç u predikua nga Pjetri dhe thirrën: «Çfarë duhet të bëjmë?» Pjetri u tha: «Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve...» (Veprat 2:38). Përmes besimit, të mbjellë në ta me anë të Fjalës, ata u penduan dhe u pagëzuan për faljen e mëkateve të tyre dhe Perëndia i bëri anëtarë të kishës. Kjo është mënyra e Krishtit për t'i bërë njerëzit të Tijtë. Kur

dikush sot ndjek këtë rrugë, Krishti do të bëjë për të çfarë Ai bëri për njerëzit gjatë ditës së Rrëshajëve. Ai e do secilin prej nesh ashtu si deshi ata, Ai vdiq për ne ashtu siç vdiq edhe për ata.

Le t'i bindemi Fjalës së Krishtit dhe t'ia dedikojmë jetët tona Atij, për të jetuar si kisha e Tij. Sipas përkrahimit të dhënë të Veprat 2, kjo duhet të bëhet duke u mbajtur pas Fjalës së Krishtit, duke jetuar me zemrën e Krishtit dhe duke mbajtur unitetin, të cilin Fryma e Shenjtë i ka dhënë Kishës së Tij.

Mos i lejoni grupet e ndryshme fetare t'ju çorodisin dhe t'ju ndryshojnë pamjen e bukur që Fryma e Shenjtë na ka dhënë për kishën e Krishtit. Kur çdo njeri vjen te Fjala e Tij pa paragjykim, ai me lehtësi mund të shikojë se çfarë është kisha dhe cili është roli i saj në këtë botë.

Tani që e dimë si duket kisha e Krishtit, le të pyesim veten tonë: «A i ngjajmë ne kishës së Krishtit?»

SHËNIME

¹Se sa shpesh duhet marrë Darka e Zotit nuk është diskutuar në këtë pjesë nga Lluqa, por ai tregon tek Veprat 20:7 se Darka merrej nga kisha në ditën e parë të javës, ditën që Jezusi u ngrit nga vdekja.

PËRGJIGJUNI PYETJEVE

(përgjigjet në faqen 235)

1. Pse themi se në kapitullin e dytë të Veprat gjejmë pamjen e parë jetës së kishës së Testamentit të Ri?
2. Diskutoni kuptimin e frazës: «ata ishin ngulmues në zbatimin e mësimin të apostujve» (Veprat 2:42). Çfarë do të thotë kjo frazë për ne sot?
3. Çfarë do të thotë «të jetosh përditë me Fjalën e frymëzuar të Tij»?
4. Çfarë do të thotë për ju fakti që Krishti është kreu i kishës?
5. A mund të ekzistojë me të vërtetë kisha e Krishtit, kur ajo nuk i bindet fjalës së Tij?
6. Shpjegoni llojin e unitetit që kishte kisha në Jeruzalem.
7. A është kisha në Jeruzalem një shembull që na jep modelin e

- dhënë nga Krishti, të cilin duhet ta ndjekim?
8. Diskutoni se si mund të hyjmë në unitetin e kishës dhe si mund ta mbajmë këtë unitet sot.
 9. Si duhet të jetë kisha e Krishtit sot?

FJALË NDIHMËSE

- apostuj** – dymbëdhjetë burrat e zgjedhur nga Jezusi për t’u bërë shpërndarësit e veçantë të mesazhit të Tij (Mateu 10:2–4). Pas vdekjes së Judë tradhtarit, Matia u emërua apostull (Veprat 1:23, 26). Më vonë, Pali iu shtua numrit të tyre (Veprat 9:15–16; 1 Timoteut 2:7). Jezusi qartësisht kërkon nga ne që t’u bindemi mësimëve të apostujve të Tij të frymëzuar nga Fryma e Shenjtë (Mateu 16:19).
- bashkësi** – të kesh interesa, ideale apo nevoja të përbashkëta. E gjithë kjo bëhet nga dashuria për njëri-tjetrin që mbush zemrat e kristianëve.
- Dita e Rrëshajëve** – festa çifute e javëve, e njohur gjithashtu si Festë e të Korrave; një festë gëzimi që festohet në ditën e pesëdhjetë pas Pashkëve; dita që shënoi fillimin e kishës (Veprat 2).
- dhembshuri** – të qenët i vëmendshëm për vuajtjet, hallet dhe problemet e të tjerëve; dëshira për të ndihmuar njerëz që ndodhen në nevojë.
- mësimet e apostujve** – mësimet dhe urdhëresat e dhëna nga apostujt. Këto mësimet gjenden në Testamentin e Ri.
- ndarjet në botën kristiane** – Në kundërshtim me lutjen e Jezusit (Gjoni 17:21) dhe mësimin e thjeshtë të Testamentit të Ri (1 Korintasve 1:10–13, 17:21), disa njerëz kanë krijuar kishat dhe doktrinën e tyre që përçajnë besimtarët në grupe të ndryshme.
- thyerja e bukës** – marrja e Darkës së Zotit (Veprat 2:42, 20:7).

UDHËZIME PËR STUDIM TË MËTEJSHËM TË BIBLËS

**Si mund të filloni të jetoni si kristianë,
pasi i jeni bindur ungjillit?**

Përkushtojuni me seriozitet rritjes shpirtërore.

2 Pjetër 1:1–10 – Bëni çdo përpjekje për t’u rritur.

Filipianëve 3:7–15 – Bëni plane për t’u rritur.

Studioni Fjalën e Perëndisë.

2 Timoteut 2:15 – Zotëroni Fjalën me mjeshtëri. (Shikoni tabelën “Përdorimi i fjalës së Perëndisë me saktësi” në mësimin “Shtojca 2”.)

2 Pjetër 3:18 – Rrituni në njohuri.

Veprat 17:11 – Studioni Shkrimet çdo ditë.

Jakobi 1:21–25 – Merreni Fjalën me përlulësi dhe bindjuni asaj.

Shtoni hirin kristian në jetën tuaj.

2 Pjetër 1:5–7 – Shtojni besimit përsosmërinë morale, njohurinë, vetkontrollin, qëndresën, respektin e thellë për Perëndinë, mirësinë vëllazërore dhe dashurinë.

Lutuni rregullisht.

Jakobi 1:5–6 – Lutuni për maturi.

1 Thesalonikasve 5:17 – Lutuni pa ndaluar.

Nderoni rregullisht

(me kristianët e tjerë, në se është e mundur).

Hebrenjve 10:25 – Mos e harroni bashkësinë. (Në se nuk ndodhet ndonjë kishë në zonën tuaj, mund të filloni një kishë në shtëpinë tuaj. Shikoni faqen 5 të mësimin “Çfarë do të bëni me Jezusin?” dhe tabelën “Si të organizojmë një bashkësi të re duke ndjekur mësimet e Biblës?” në mësimin “Shtojca 2”.)

Gjoni 4:24 – Nderoni në shpirt dhe në të vërtetën.

Tregojuni të tjerëve për Jezusin.

Mateu 28:18–20; Marku 16:15–16 – Mësoni çdo njeri që të mundeni. (Bëni të mundur që shokët tuaj të lexojnë këtë libër dhe ndihmohjini ata të bëhen kristianë.)

Autor: *Eddi Cloer*

Marrë nga libri: “*Si të bëhesh një kristian besnik*”

© 2003 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara